



Si duhet vepruar në rast diskriminimi?

Antidiskriminierungsbüros NRW

Ruani qetësinë dhe veproni me maturi!

Edhe në rast se Ju kanë ofenduar, dhe që Ju ndjeheni të provokuar përmes diskriminimit, në këtë situatë rregullisht kryesor është: **Ruani qetësinë dhe veproni me maturi!** Një ankesë me zë të lartë apo një ofendim karshi diskriminuesve mund të jetë më vonë për Ju një disfavor. Mos e leni veten të provokoheni. Shpesh diskriminuesit e përdorin këtë, me qëllim që t'u padisin (!), dhe kjo e vështirëson në thelb zbatimin e të drejtave tuaja.

Prandaj qëndroni mundësisht të qetë dhe konstatooni fillimisht, nëse ka dëshmitare apo dëshmi për rastin e diskriminimit. Nëse klientë apo kalimtare e kanë vëzhguar ndodhinë, më mirë bisedoni me këta persona direkt në këtë situatë dhe shënoni emrat dhe numrat e tyre të telefonave, me qëllim për t'i përmendur ato më vonë si dëshmitare. Siguroni dëshmi (si p.sh. letra, e-maile, screenshots, bileta etj.) me të cilat Ju mund të dëshmoni diskriminimin.

Organizoni mbështetje. Bisedoni me shokët tuaj/shoqet tuaja dhe familjen tuaj lidhur me diskriminimin e përjetuar dhe përdorni për shembull ndihmën e **zyrës kundër diskriminimit NRW** (shih broshurën) apo të një qendre tjetër konsultimi. Në këtë mënyrë do të sigurohet mbështetja dhe ndihma për mënyrën e mëtejshme të veprimit.

Protokoll i kujtesës

Pas ngjarjes Ju duhet të bëni menjëherë një protokoll kujtese. Është e rëndësishme, që të mund të dokumentoni, që Ju jeni diskriminuar. Shënoni:

- **Ku** dhe **kur** ka ndodhur kjo ngjarje? (p.sh. në një dyqan të madh shitjeje, data, ora)
- **Çfarë** ka ndodhur me saktësi? (p.sh. një dyshim i pajustificuar përmes shitësit/shitëses, kontrolli i xhepave fare hapur nga ana e personelit ofendues të sigurimit)
- **Kush** ka qenë i pranishëm në ngjarje? (p.sh. personeli i shitjes dhe i sigurimit)
- Kush ka qenë **dëshmitar/dëshmitare**? Çfarë **dëshmish** ekzistojnë?
- A është thirrur policia?
- **Përse** u veprua në disfavorin tuaj? Çfarë ju bën të mendoni, se jeni diskriminuar për shkak të origjinës suaj, ngjyrës së lëkurës, fesë apo gjuhës?

A kërkoni Ju të drejtat tuaja!

Në rast se Ju jeni diskriminuar dhe dëshironi të mbroheni kundër saj, atëherë duhet që brenda një **afati prej 2 muajsh** të vini autoritet kundrejt personit diskriminues/zyrës. Këtë do ta bëni më mirë në formën e ankesës me shkrim.





Ku duhet të gjej mbështetje?

Në Nordrhein-Westfalen ekzistojnë pesë zyra kundër diskriminimit, të cilave Ju mund t'i drejtoheni, në rast se Ju do të jeni të diskriminuar. Krahas këtyre qendrave kundër diskriminimit ekzistojnë edhe institucione konsulte, të cilat mund t'ju ndihmojnë më tej. Adresat e qendrave kundër diskriminimit të federatës në Berlin dhe vende të tjera do t'i gjeni poshtë <http://www.agg-ratgeber.de/adressen-kontakte.php>

Qendrat e sipërpërmendura mund t'ju ndihmojnë më tej në mënyrën sa vijon:

Shoqërim dhe mbështetje:

Pikësëpari këshilltari/këshilltarja sqaron me Ju, se çfarë ka ndodhur me saktësi. Për këtë ju ndihmon protokoli i kujtesës. Bashkërisht ata ju këshillojnë për procedimin e mëtejshëm. Ju mund të kërkonit një zgjidhje jashtëgjyqësore (p.sh. letër ankese apo bisedë personale), ose të ngrini një padi. Veç kësaj në rast nevojë Ju do të merrni mbështetje shpirtërore, me qëllim për të përpunuar diskriminimin e pësuar. Përfundimisht gjatë konsultimit ju sqarohet, se çfarë mundësisht ligjore keni Ju, me qëllim për të vepruar kundër diskriminimit.

Ndërmjetësim konflikti:

Qendra e konsultimit mund të organizojë një bisedë të përbashkët ndërmjet jush dhe palës kundërshtare, në praninë e një ndërmjetësuesi/ndërmjetësueseje konflikti. Kjo do të ishte atëherë e kuptimplotë, në rast se Ju personat diskriminues nuk mund t'i evitoni dot (p.sh në territorin e banimit, në punë apo në supermarketin fare pranë).

Puna në publik:

Në rast se Ju përmes mjeteve të mësipërme nuk arrini dot qëllimin, atëherë me ndihmën e qendrës së konsultimit Ju mund t'i drejtoheni mediave. Shpesh kjo është një mënyrë efikase për të ushtruar presion mbi diskriminuesit.

Konsultimi është falas.

Quelle: <http://www.agg-ratgeber.de/checkliste.php> + <http://www.agg-ratgeber.de/unterstuetzung-durch-beratungsstellen.php>

Qendrat e shërbimit për punë kundër diskriminimit (zyrat kundër diskriminimit NRW)

Pädagogisches Zentrum Aachen e.V.
Gleichbehandlungsbüro
Mariahilfstr. 16
52062 Aachen
Tel: 0241 4017778
Fax: 0241 49004
E-Mail: gbg@paez-aachen.de
www.gleichbehandlungsbuero.de

Planerladen e.V.
Schützenstraße 42
44147 Dortmund
Tel. 0231 8820700
Fax: 0231 8820701
E-Mail: integration@planerladen.de
www.integrationsprojekt.net
www.planerladen.de

Anti-Rassismus Informations-Centrum, ARIC-NRW e.V.
Friedenstr. 11,
47053 Duisburg
Tel: 0203 284873
Fax: 0203 9357466
E-Mail: info@aric-nrw.de Internet:
www.aric-nrw.de

AntiDiskriminierungsbüro (ADB) Köln
Öffentlichkeit gegen Gewalt e.V. (ÖgG)
Berliner Straße 97-99
51063 Köln
Tel: 0221 96476300
Fax: 0221 96496709
E-Mail: info@oegg.de
www.oegg.de

Antidiskriminierungsbüro
Südwestfalen
Heidenbergstr. 1c
57072 Siegen
Tel: 0271 3175745
E-Mail: guel.ditsch@vaks.info
www.vaks.info
www.mediathek-siegen.de